

Prof. dr. Arian KADIU

## DASMA E SYNETIT NË DIBËR TË MADHE

Me miliona meshkuj janë bërë synet dhe me qindra mijë të tjerë bëhen synet edhe sot e kësaj dite. Po kuptimi i nevojës së rrethprerjes, ka ndryshuar në varësi të zhvillimeve historike dhe përhapjes së qytetërimeve në epoka të ndryshme. Tashmë kjo dukuri është e njohur dhe e përhapur në shumicën e vendeve që më parë nuk e pranonin këtë rit, duke i veshur asaj vetëm përmbajtjen fetare. Si në të gjithë përkujdesjet e tjera ndaj njerëzve, edhe ky rit shërben si një mjet profilaktik për mashkullin, sepse eviton mikrobet, që mund të bëhen shkaktare të dramave njerëzore dhe të sëmundjeve të pashërueshme. Me anë të synetit të dy sekset ruajnë njeri-tjetrin.

Në Dibër të Madhe syneti bëhet si dasmë, sepse nuk e dallon asgjë prej saj. Shiko njerëzit që vijnë, shpenzimet e tjera, duke shkuar deri te darka e madhe, ku këndojnë, zakonisht këngëtare shqiptare. Për të marrë pjesë në dasmën e synetit, vijnë edhe njerëzit e kushërinjtë e tyre, që jetojnë jashtë shtetit. Syneti festohet e urohet nga të gjithë ata që e dëgjojnë si në lagje, ashtu edhe në qytet.

Si çdo ngjarje tjetër e shënuar në jetën e njeriut, syneti ka ritualin e vetë, cili pak ka ndryshuar.

Ditën e caktuar të synetit, njerëzit ngrihen herët dhe gratë ia nisin këngës së bukur. Është një këngë e gëzuar, një këngë feste dhe motivimi. Në qendër të saj është djali që do të bëhet synet, i quajtur Edon. Kjo ngjarje ngre nga dysheku edhe gjyshin e sëmurë (i cili, në këtë qytet, për respekt quhet babë, kurse i ati i djalit thirret babi):

O këndojnë dy zoga,  
çardak e penxhere,

o këndojnë e s' pushojnë,  
Edonin e mçojnë  
Ta lajnë e ta ndërrojnë  
sinet dun ta bëjnë,  
nanës s'i dëftojnë  
mizhden ia kërkujnë.

Gëzimi i njerëzve për këtë synet është i ligjshëm. Djali do t'i nënshtrohet një lloj operacioni, por, më pas do të jetë i sigurt për të gjithë jetën. Në valle hyjnë shumë njerëz, ndonëse shumica e tyre janë gra. Ata e heqin vallen ngadalë, ia përshtatin hapin ritmit të këngës, të cilën e këndojnë vetë. Në valle gratë nuk janë kapur dorë për dore, por shkojnë varg njëra pas tjetrës. Në dorën e djathtë të ngritur tundin shaminë, kurse të majtën e kanë vënë në bel. Këto valle të kënduara zgjasin zakonisht 10-15 minuta.

O pëllumb-o me shoumë fjetë,  
O Edon u bofsh me jetë,  
U ngrëjt baba pi n' dishek  
Ta bëj sinet-o nëjpin e vet.  
O pëllumb-o me shoumë fjetë  
O Edon u bofsh me jetë,  
Shiqir xhixhe që ke ngjef  
Ta bojsh sinet-o nëjpin e vet..  
Shiqir bab-o që ke ngjef  
Ta bojsh sinet-o gjalin e vet.  
Shiqir mami që ke ngjef  
Ta bojsh sinet gjalin e vet.

Pas kësaj kënge dhe këngëve të tjera, vjen koha, kur djali do të lahet që të shkojë i pastër për t'u bërë synet. Edhe për këtë rast banorët e kësaj treve kanë krijuar këngë të tjera, që e shoqërojnë gjatë ritit të larjes së djalit.

Hajde tët lan nana,  
Ma mëjr se të tana  
Eja tët lan xica,  
Ma mëjr pi të gjitha,.

(e kështu me radhë, përmenden gratë më të afërta në farefisni).

Më pas djali do të vishet me rrobat e reja ose me rroba të pastra, të lara e të hekurosura. Edhe kur djali vishet, ka një këngë enkas për këtë gjë. Pra, sikurse kuptohet, populli ka “inçizuar” gati çdo veprim që kryhet në ceremoninë e bukur të synetit. Kënga e radhës është kjo:

Mor Edon, mër jallëj  
na e gëzof mitanin mavëj,  
Nana Behare fol e çesh  
i ka pru Edonit peshqesh.  
Ju moj gra kur ta çëlloni,  
Mashalla, gjalit t’i thoni,  
thoni djalit mashalla,  
Është i vogël, është gjynah.  
Tarnana, o lule xheneti,  
murat i madh, o që ka sineti  
Tarnana, o lule vërëjni  
murat i madh-o që ka shpëtëjmi  
Krisi moti, krisi zamani  
sinet si ki s’kishim pamun  
se kështu në murat të parë,  
Zoti na e sjelltë mbarë  
Na u shtofshin si gruni n’arë  
Ishalla, xhishi tët rroj,  
që të ngjefi të të martojë,  
Shiqir mixha që të ngjefi,  
ta bëj nëjpin sinet.

Nga këngët e kërcyera del se ceremoniali sapo ka filluar, sepse mjaft këngë të tjera janë kënduar nga populli shekuj më parë për ngjarje të gëzueshme familjare.

Edonit që, mbase ngashërehet, i premtohet t’ia plotësojnë dëshirat që në synet të shkojë i qetë:

Qan Edoni në abdesane  
(pas këtij vargu djali thotë: po unë nuk po qaj)  
I kërkon babës qemane,

A do qemane e muzika,  
A do putëjna me llastika,  
Putëjnat janë jasat,  
Pumat- o kanë dalë bidat.

Dikush lajmëron “erdhi berberi!”, i cili vjen vetë i dytë. Një nga të afërmit e djalit, zakonisht një dajë i ri, ka shkuar ta presë berberin në shtëpinë e tij. Kur synetet i kryenin berberët, riti bëhej në shtëpinë e djalit. Ndonëse disa gjëra kanë ndryshuar, përsëri populli i këndon edhe këngët e stisura posaçërisht për berberin. Ndërkohë, dasmorët, njerëzit e afërt, gra të lagjes, vajza etj. këndojnë këngën e berberit:

Vjen berberi kaj Qërnanëjca,  
Edonit i shkojnë muarnëjca,  
Tokën berberi në derë,  
çilma derën-o,  
prëje ta pëjsi babën-o,  
që ta çeli derën-o.  
Ene baba kështu më tha,  
Hip berber në odë erma.

Në Dibër të Madhe ka mbetur zakoni: i veshin fëmijët që do të bëhen synet me rrobe mbretërore. U veshin sipër një pelerinë të artë, kurorë të artë në kokë dhe një stap ose skeptër po të artë në dorë. Më pas djali i veshur me rrobat e i përcjellë nga gratë, (të cilat i kanë bërë edhe adetin e mos marrjes mësysh) vjen në konakun e burrave, të cilët e shikojnë dhe e urojnë. Sapo del djali bëhet një dua (lutje) Allahut për ta pasur synetin e lehtë e me sukses.

Tej për tej me xheth të njomë,  
mblidhi nuose të këndojmë  
se Edonin sinet ta bëjmë  
mal e fusha t’i xhëmojmë

Kur bohet sinet një menzëj pam  
ene dasma bohet veçan,  
menzej pam i rrëjtun-o

ç'ish ka pazari i kanëjtun-o  
nana Desi e ka rrëjtun-o  
nana Behare ia shef dy sëjt.

Pasi ndahet nga burrat, djalin e shëtisin nëpër qytet. Ai kalon me një karrocë të stolisur, në një tjetër janë muzikantët dhe në një karrocë të tretë shokët e djalit, (moshatarët). Karrocet stoliseshin më mirë se kur merrnin nuse. Kuajt tundnin në qafë zilkat e praruara, karrocierët u binin borive të ndryshme, në karrocë varshin lule, shirita shumëngjyrësh, kalit i varnin në të dy veshët shami të kuqe të qëndisura e shumë zbukurime të tjera si lodra të tjera.

Në ditët tona, në vend të karrocës përdoret makina, të cilat shkojnë varg njëra pas tjetrës, gati deri në tetë-dhjetë. Ndërkaq, nga shumë makina, dëgjohet zhurma e magnetofonave, të cilat janë hapur në maksimum. Ngjarja është festive dhe të gjithë pyesin se kush bëhet synet. “Me shëndet! Zoti e ndihmoftë!” – urojnë ata. Pas dy xhirove nëpër qytet, dajallarët e drejtojnë djalin për në klinikën mjekësore.

Në shtëpi gratë e vajzat, këndojnë këngë që lidhen me Edonin:

Ulun Edoni në shkallë  
e kërkon kalin me shalë,  
me një tufë dajallarë.  
Daja Shpend ma i parë  
e çojnë në Këllëçbabë.  
O Edon, allten-top,  
Me kollajllëk të shpëtoftë Zoti  
Me kollajllëk si gjithë dynjaja.  
Si zengjini e fukaraja  
Ene ne me Zotin para.

Edhe nga këto vargje të këngës popullore, kuptohet lehtë se poeti anonim ka fiksuar edhe mjaft detaje, që tërheqin vëmendjen të gjithë ceremonisë së synetit. Del se në kohë më të hershme, djalin e dërgonin për të shëtitur edhe me kalë.

Këngëtarët, duke e njohur gjendjen shpirtërore të djalit që bëhet

synet, mendojnë gjithnjë se usta berberi që do të bëj synet djalin e tyre, është një berber i zoti. Në kohën kur djali po bëhet synet në klinikë, ende këndohet një këngë interesante, ku gjejmë dialogun mes babait dhe djalit dhe e gjithë fjala e tyre përqendrohet tek berberi, tek zotësia e tij, që djali të mos ketë dhimbje:

Hip e ulu në minder  
 të të ap një kokërr sheqer,  
 Ulu babë në sandallëj,  
 se kam frikë t'ulem ke tëj.  
 O mor, babë të kam të lutun,  
 Me një zemër të këputun:  
 -Në të ngjafte usta-berber  
 mbushja gojën me sheqer,  
 në s'të ngjafte usta-berber  
 mbushja gojën me biber.  
 Në të ngjafte usta-ka pak,  
 mbushja gojën me çikollatë,  
 në të ngjafte usta ka shumë  
 mbushja gojën me llokum.

Pasi ka ardhur në shtëpi, burrat e më pas gratë, shkojnë e i dhurojnë para djalit, sipas afërsisë që kanë me familjen e tij dhe gjendjes së tyre ekonomike.

Në mbrëmje shtrohet një darkë e madhe në një nga lokalet e mira të Dibrës së Madhe, ku, mbase më e preferuara është salla e veshur me kadife të kuqe, ku janë shtruar edhe tavolinat, por ka edhe mjaft vend edhe për të kërcyer.

Pasi ka mbaruar dasma e synetit (quhet dasma e synetit edhe në të folurën e përditshme), të nesërmen është ditë e xhuma (ditë e veçantë urimesh). Syneti zakonisht bëhet të enjten, kështu që e xhumaja i takon dita e saktë (e emërtuar kështu), por edhe kur nuk bëhet të enjten, dita e nesërme është e xhuma, pasi vijnë për vizitë gratë.

Si kjo dasëm me lezet,  
 na merr malli ta bajmë opet.  
 Mor Arëjf, mor hanedan

e bone dasmën si në zaman  
se në vakt ke babën tand,  
zihet mishi në kazan  
me kazan, me haraçëja  
se ashtu na e çon shtëpëja.  
Kjo shtëpëj ashtu osht mësue  
kur i ka ra e ka xhëmue,  
nuk e kanë për ndonje sedër  
na e kanë lanë pjeçtë e vjetër  
nuk e kimi për inat,  
po ashtu e kimi zanat.

Janë të tjera këngët që këndohen kur largohen gratë, të cilat respektohen dhe urohen për mbarësi dhe gëzime të tilla në familjet e tyre dhe me fëmijët e vet:

Ju moj gra qi na keni ardh,  
jalla paçi paçen e bardhë,  
Ju na erdhët për nazelinë,  
ua pagofshim për fëmijnë.  
Jalla kush na lavdëroftë  
zemrën tande na diktoftë.  
ene juve mos ua harrofshim,  
për të mëjr ua pagofshim,  
ene u shkojshim e këndofshin

Ti moj (këtu përmendet emri i gruas që ka ardhur për vizitë.  
Kjo bëhet edhe për gratë e tjera)... të bojmë rixha,  
të na thërrasësh ene na,  
nuk dum të ham e të pëjmë  
të këndojmë e të kërcejmë,  
në mos paçim çish me ngranë  
do pëjmë ujë e do ham ranë,  
në mos paçim ku me fitë,  
natën do ta bojmë ditë.

## Fjalori:

Shprehje: Na u shtofshin si gruni n'arë - të shtohen synetet e djemve.

Ç'kish ka pazarii kanëjtun-o - çdo gjë të mirë që shitet në Pazar, ai e ka provuar.

Se në vakt ke babën tand - e ke familjen në gjendje të mirë ekonomike.

mçëjnë - zgjojnë,

dun - duan,

shoumë - shumë,

pi - prej,

mizhden - para (të holla) që jepen për sihariqin,

bojmë - bëjmë,

fjetë - pupla, fletë,

ngrëjt - ngritur,

nëjpin - nipin,

prëjt-prit,

ngjef - rrojtur, që ke arritur

menzëjпам - me kuptimin e kanë djalë kimeti, të vetëm

abdesane - vendi ku lahen sytë në mëngjes,

qemane - gërnnet e violinë-saze-,

shiqir- shyqyr;

qesh - qesh,

mavëj - (ngjyrë) mavi,

mitanin - këmishë,

çëlloni - shikoni,

gjalit - djalit,

murat - gëzim,

vërëjni - vëri (lloj druri),

xhishi - gjyshi,

muarnëjca-mornica,

tokën -troket,

erma- lart.

bojmë - bëjmë,

putëjna - këpucë me qafa,

mëjr - mire,

xica, xhixha - xhaxhesha,

Qernanajca - Qershnanica - emër vendi, me rëndësi historike,  
Këllëçbaba - vend i shenjtë, emër teqeje,  
sandallëj - karrige,  
bidat - diçka e re, e kohës  
opet - prapë,  
pjeçtë - pleqtë,  
të bojmë rixha - të lutemi shumë,  
jalla - (urim) nga: ishallah ,  
pëjmë - pimë,  
fitë - fjetur,  
zaman - si në kohërat e mëparshme,  
xhëmue- gjëmuar,  
çish - çfarë

*(Kënduar nga Bujare Rusi, Dibër e Madhe, gusht 2005).*